



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 92, Datë 28.04.2022

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “POWER COMM” SH.P.K., PËR HEQJEN E LICENCËS  
SË VEPRIMTARISË SË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME NR. 466,  
SERIA T20**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, gërma “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 5, gërma “dh”; nenit 7, paragrafi 2 dhe nenit 9, gërma “d”, të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.04.2017; nenit 18, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshur; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.04.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 579/1 prot., datë 20.04.2022 të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “PowerComm” sh.p.k., për heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike me nr. 466, seria T20, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 92, datë 02.06.2020”,

**Konstatohet se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 92, datë 02.06.2020, ka licencuar shoqërinë “PowerComm” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5 vjeçar.
- Shoqëria “PowerComm” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 511/1 prot, datë 15.04.2022, ka bërë me dije se që nga data 09.03.2021 ka pezulluar aktivitetin e saj tregtar për arsye financiare (dokumentuar edhe me Ekstraktin Historik të saj të depozituar në ERE, nga i cili rezulton se statusi i shoqërisë është “Pezulluar”) dhe si e tillë kërkon edhe heqjen e licencës nr. 466, Seria T20, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 92, datë 02.06.2020.
- Shoqëria ka dokumentuar edhe kryerjen e pagesës së rregullimit për vitin 2021 dhe rezulton se kjo shumë ka kaluar në llogarinë e ERE-s dhe shoqëria nuk është debitore ndaj pagesave të rregullimit.
- Kërkesa e shoqërisë “PowerComm” sh.p.k., për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike mbështetet në parashikimet e nenit 42, pika 1, gërma “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në të cilin citohet se: *ERE heq një licencë me kërkesë të të licencuarit*; si dhe nenit 5, gërma “dh”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, e cila parashikon se: *“Licenca hiqet me kërkesë të të licencuarit”*.

- Në Rregulloren për procedurat e heqjes së licencës në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, neni 7, paragrafi 2, përcaktohet se: “Në rast se nga i licencuari është propozuar për t’iu hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat “dh” dhe/ose “e”, të nenit 5, të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9, të kësaj rregulloreje”.
- Rregullorja për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror“, në nenin 9, gërma “d”, të saj, përcakton se: “...Bordi do të vendosë për të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat "dh" dhe / ose "e" të nenit 5, të kësaj rregulloreje, në përputhje me nenin 7, paragrafi 2, të kësaj rregulloreje”.
- Në kushtet kur kërkesa për heqjen e licencës vjen nga vetë i licencuari, legjislacioni në fuqi i sipërcituar, i jep ERE-s të drejtën ligjore për t’u shprehur me një vendim miratimi pa kaluar më parë në fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “PowerComm” sh.p.k., për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike me nr. 466, Seria T20, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 92, datë 02.06.2020.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi licenca me nr. 466, Seria T20, humbet fuqinë juridike.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**